



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr 248/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes parazgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 1000 (njëmijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi

Arsyetim

PZAP-i, më datë 08.06.2014 ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik PDK dega në Prishtinë, në të cilën theksohet se aktivistët e LDK-së, kanë vërejtur se në qytetin e Prishtinës, konkretisht Rruga “ Vëllezërit Fazliu” rreth orës 12:00 me datën 08 qershor 2014, aktivistët e LDK-së kanë përdorur simbole dhe flamuj të LDK-së, duke shëtitur me vetura me qëllim për të bërë fushatë. Me këtë rast parashtruesi i ankesës konsideron se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së 03/L-073. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografitë nga vendi i supozuar i ngjarjes.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës me datën 08.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj saj nga ana e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 09.06.2014 në ora 17:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga LDK dhe konsiderojnë se ankesa e ushtruar ndaj tyre është e pabazuar nga fakti se fotot e bashkangjitura si provë nuk vërtetojnë datën dhe orën e ngjarjes së ndodhur të supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet se si aktivistët e LDK-së kanë përdorur simbolet dhe flamujt e subjektit të tyre gjatë ditës së votimit veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik LDK është përgjegjës për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, e cila përcakton se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja e fushatës në çfarëdo mënyre dhe meqenëse aktivistët e LDK-së gjatë ditës së zgjedhjeve kanë shëtitur me vetura duke përdorur simbolet dhe flamujt e LDK-së, e bëjnë përgjegjëse subjektin politik në fjalë andaj këto veprime kanë ndikuar në caktimin e lartësisë së gjobës së shqiptuar.

Prandaj PZAP-i në kuptim të nenit 36.1 pika b) dhe nenit 120 paragrafi 1 pika c), lidhur me nenin 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 248/2014 më datën 09.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha**



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*